



Rezoluta A/66/209 e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit

Më 22 dhjetor 2011, Asambleja e 66 e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (KB) miratoi Rezolutën 'Promovimi i efikasitetit, llogaridhënies, efektivitetit, dhe transparencës në administratën publike përmes forcimit të institucioneve supreme të auditimit'

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të KB është konkluzioni që kurorëzon përpjekjet e përbashkëta të të gjitha ISA-ve për forcimin e pavarësisë së tyre dhe për njohjen e Deklaratave të Lima-s dhe Meksikës. Ky sukses ishte i mundshëm vetëm sepse të gjithë anëtarët e komunitetit të INTOSAI-t krijuan kushtet e nevojshme në fushat kompetente të tyre dhe në këtë mënyrë i kanë dhënë kuptim dhe besueshmëri motos së INTOSAI-it 'përvoja e përbashkët i sjell dobi të gjithëve'.

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të KB përfaqëson një moment të veçantë në historinë afro 60 vjeçare të INTOSAI-t. Në këtë rezolutë, Asambleja e Përgjithshme për herë të parë pranon qartë se:

- ISA-të mund ti përmbushin detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive vetëm nëse ato janë të pavarura nga entiteti i audituar dhe të mbrojtura nga ndikimi i jashtëm; si dhe pranon
- Rolin e rëndësishëm të ISA-ve në promovimin e efikasitetit, llogaridhënies, efektivitetit, dhe transparencës në administratën publike, i cili çon në arritjen e objektivave dhe prioritetëve kombëtare për zhvillim si dhe të synimeve për zhvillim të pranuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë Synimet Zhvillimore të Mileniumit.

Shtetet anëtare të KB me kënaqësi i kushtojnë vëmendje të veçantë:

- Punës së INTOSAI-it në promovimin sa më të madh të efikasitetit, llogaridhënies, efektivitetit, dhe transparencës dhe në pranimin dhe përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve publike në të mirë të qytetarëve; dhe
- Deklaratave të Lima-s dhe Meksikës.

Asambleja e Përgjithshme e KB inkurajon shtetet anëtare të:

- Aplikojnë parimet e përcaktuara në ato deklarata në pajtim me strukturat e tyre kombëtare institucionale,

si dhe inkurajon

- Shtetet anëtare dhe institucionet relevante të Kombeve të Bashkuara që të vazhdojnë dhe të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre me INTOSAI-n, duke përfshirë edhe atë në ngritjen e kapaciteteve, me qëllim të promovohet qeverisja e mirë duke siguruar efikasitet, llogaridhënie, efektivitetet, dhe transparencë përmes institucioneve të forcuara supreme të auditimit.

Të gjitha ISA-të kanë tashmë në dispozicion një rezolutë të Kombeve të Bashkuara, e cila i lejon atyre të kërkojnë më me këmbëngulje zbatimin e parimeve themelore të pavarësisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fushën e ngritjeve të kapaciteteve nga ISA-të, duke qenë se pavarësia e tyre institucionale, dhe veçanërisht nga entitetet e audituara, për herë të parë është njohur nga të gjitha shtetet anëtare të KB.

Inkurajimi që Asambleja e Përgjithshme i bën shteteve anëtare të KB për të zbatuar parimet e përcaktuara në Deklaratat e Lima-s dhe Meksikës do të rrisë vendosmërinë e të gjitha ISA-ve, veçanërisht të atyre që po luftojnë të arrijnë elementet themelore të pavarësisë së tyre.